



NJOFTIM PËR EKSPERTIZË TË JASHTME

“Arkitekt / Inxhinier Ndërtimi”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipet Sportive ne Shkolla**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për ekspertize e jashtme në pozicionin “**Arkitekt / Inxhinier Ndërtimi**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talentëve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projektin do të formojë Ekipet sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme.

Detyrat e “**Arkitektit / Inxhinier Ndërtimi**”

- Projektin, planifikon afatet e dorëzimit të projektit arkitekturës dhe mbikqyr gjatë fazës së zbatimit të ndërtimit;
- Te njohë shumë mirë ligjet-rregulloret në fuqi ,si per sa I përket projekt - zbatimit ashtu dhe në përgatitjen e dokumentacioni Teknik;
- Të ketë njohuri shumë të mira mbi normativat e projektimit për kategori të ndryshme.
- Përgatit plane të detajuara, të cilat tregojnë saktësisht se si do të ndërtohet struktura, duke përfshirë informacione teknike, ose specifikime, të materialeve të përdorura dhe metodat e instalimit.



Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Diplomë Universitare në Arkitekturë;
- Minimumi 5 vite përvojë relevante pune;
- Aftësi të larta krijuese dhe inovatore;
- Aftësi për të analizuar proceset e punës dhe procedurat dhe për të identifikuar mundësi përmirësimi;
- Aftësi të larta profesionale në modelim 2 dhe 3 dimensional.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare për Arkitekt/Inxhinier Ndërtimi.

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Prill

2024, ora 12.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, ose fizikisht pranë zyrave të KOKSH.